

**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI**

(TË SHOQËRISË “GEA” SH.P.K)

Prot 14

Data. 03.08.2021

**SHITËS:**

**Shoqëria GEA SH.P.K**, regjistruar si person juridik në QKB ( Qendra Kombëtare e Biznesit) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M01412044I, me adresë Rruga ‘ 5 Maji’ Vila L, Njësi Shërbimi Nr.4 Shkalla 1, Kati përdhe , përfaqësuar nga administrator Elson Frroku, atësia Pashko, amësia Angjelinë, shtetas Shqiptar , lindur në Lezhë dhe banues në Lezhë, me adresë Luigj Gurakuqi 03070057; Nd. 32; h.9; Ap. 5; Lezhë ; Lezhë ; 4501; Lezhë , lindur më 17/01/1990, gjendja civile “ i martuar”, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar , për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftimin ID nr. 033799377 dhe nr. Personal J00117088K.

**BLERËS:**

**Reinis Çela**, atësia Agron, amësia Fetije, shtetas Shqiptar i lindur në Lezhë dhe banues në Lezhë, me adresë Bulevardi Gjergj Fishta , pallati Boga përballë kopshtit Beslidhja, Lezhë; Lezhë 4501; Lezhë, lindur më 02/05/1988, gjendja civile “ i martuar”, madhor , me zotësi të plotë juridike për të vepruar , për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftimin ID nr . 036799431 dhe nr. Personal I80502081N.

**OBJEKTI:** Shitja e kuotave të shoqërisë “ GEA” SH.P.K në masën 15% të kapitalit që zotëron ortaku kryesor i shoqërisë Z. Elson Frroku me cilësinë e shitësit dhe blerja e tyre nga ortaku Reinis Çela me cilësinë e blerësit.

**PËRMBAJTJA E KONTRATËS**

Shoqëria GEA SH.P.K është regjistruar pranë QKB sipas Ekstraktit Historik i regjistrimit i datës 12/02/2020 me nr NIPT M01412044I

Shitësi **Z. Elson Frroku**, është plotësisht dakord të shesë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë 15% të kuotave që ai zotëron në GEA SH.P.K. Kjo shitje kuotash sipas kësaj kontrate do të bëhet në favor të blerësit **Z. Reinis Çela**, duke u bërë kështu ortaku i shoqërisë në masën 15% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Blerësi, **Z. Reinis Çela**, është plotësisht dakord që të blejë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë , masën prej 15% të kuotave të zotëruara nga shitësi në kapitalin themeltar të shoqërisë tregëtare “GEA” SH.P.K.

**MENYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE**

Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitësi, ortaku i shoqërisë Z. Elson Frroku humbet pronësinë në masën 15% të kuotave të zotëruara prej tij në kapitalin themeltar të shoqërisë GEA SH.P.K, duke zotëruar kështu 55% të kuotave në kapitalin themeltar ndërsa blerësi Z. Reinis Çela bëhet pronar i 15% të kuotave të shitura , më të gjitha të drejtat dhe detyrimet që mbart blerja e këtyre kuotave.



Shoqëria Tregëtare 'GEA' SH.P.K, pas realizimit të këtij operacioni shit-blerje kuotash , sipas kësaj kontrate , do të ketë si ortakë në masën 55% Z. Elson Frroku, ortak në masën 30% Z. Altin Herceku dhe në masën 15% Z. Reinis Çela të kapitalit themeltar.

### ÇMIMI I SHITJES SË KUOTAVE

Si çmim i këtij transaksioni shit-blerje kuotash të shoqërisë "GEA" SH.P.K do të jetë shuma prej **15.000 lek**, çmim i cili bazohet në vlerën e kapitalit që ka kjo shoqëri, vlerë e cila është likujduar totalisht nga pala blerëse Kesh në Dorë.

Sipas këtij përcaktimi, Blerësi **Z. Reinis Çela**, do të paguajë në favor të shitësit **Z. Elson Frroku**, shumën prej **15.000 lek**, shumë e cila është paguar jashtë kësaj zyre dhe shitësi nuk do të ketë sot dhe në të ardhmen pretendime për këtë shumë apo për çdo shumë tjetër.

### DISPOZITA TË FUNDIT

Kontrata hartohet në pese kopje të njëjta nga të cilat një e mbajnë palët , një kopje depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe një kopje depozitohet në aktet e shoqërisë

**SHITËSI**

**GEA SH.P.K**

**ADMINISTRATORI**

**Elson FRROKU**



**BLERËSI**

**Reinis CELA**